



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 186/1 Prot.

Tiranë, më 10.03.2016

V E N D I M
Nr.22, datë 10.03. 2016

*“Për plotësimin e vendimit nr. 14, datë 29.01.2016, të Komisionerit
“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 646/1 Prot., datë
08.10.2015”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me informacionin e ardhur nga punonjësja *****, aktualisht në detyrën e Drejtores në Drejtorinë Arsimore Rajonale, për parregullsi që kanë të bëjnë me mënyrën e pagesës së nëpunësit civil, gjatë kryerjes së detyrës,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 646/1 Prot., datë 08.10.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të informacionit të marrë nëpërmjet shkresës nr. 646, datë 23.09.2015, të dërguar nga nëpunësja e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, *****, është kryer procesi i verifikimit të ligjshmërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të nëpunësit civil, nga ana e subjekteve të njohura me ligj për administrimin e shërbimit civil, e po kështu, është zgjeruar hetimi administrativ, edhe në aspekte të tjera të zbatimit të ligjit nr.152/2015 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioneri është shprehur me vendimin nr.14, datë 29.01.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 646/1 Prot., datë 08.10.2015”, në përmbajtjen e të cilit janë materializuar parregullsitë e konstatuara gjatë administrimit të shërbimit civil dhe në dispozitivin e tij, është urdhëruar njësia përgjegjëse për të rregulluar situatën, nëpërmjet detyrave konkrete të lëna për t`u realizuar në këtë rast.

Ashtu si është analizuar edhe në vendimin e mëparshëm të Komisionerit, në lidhje me rastin e punonjësës *****, rezulton e provuar se, kjo nëpunëse ka filluar punë për herë të parë, pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, me aktin e emërimit nr. 288 Prot., datë 18.02.2011, në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë”, me nivel page, IV-b dhe me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit nr. 2116/25, datë

14.08.2014, kjo punonjëse ka fituar për shkak të ligjit, statusin “*Nëpunës civil*”, në këtë pozicion.

Më tej, rezulton se në kuadër të zhvillimit të karrierës, në datën 18.08.2015, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, kjo nëpunëse është shpallur fituese dhe është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë*”, në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë, kategoria e pagës IV-a.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje, vërtetohet se kjo punonjëse, ndërkohë që ka qenë e punësuar në pozicionin e punës “*Specialiste në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë*”, në muajin Maj 2014, me anë të shkresës nr. 3642/3 prot., datë 27.05.2014, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për nevoja urgjente të punës, është ngarkuar të kryejë detyrën e Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë.

Ky akt, është diktuar nga fakti se, drejtuesja e mëparshme e kësaj drejtorie ishte pezulluar nga puna për shkak të nisjes së një ecurie disiplinore, ecuri e cila ka përfunduar me aktin nr. 15, dt. 16.06.2014, me largimin e saj nga detyra.

Me mbarimin e afatit të komandimit nëpërmjet aktit të mësipërm, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë, me aktin tjetër nr. 3642/8, datë 14.07.2014, të Sekretarit të Përgjithshëm, nëpunësja ***** është ngarkuar përsëri të kryejë detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, për një periudhë tjetër, 6 mujore.

Rezulton se edhe pas mbarimit të këtij afati 6 mujor, me shkresën nr. 605 prot., datë 27.01.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm, është urdhëruar përsëri, që kjo punonjëse, “*...ngarkohet që të kryejë përkohësisht, detyrat e Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë*”, por këtë herë pa afat të përcaktuar.

Në të gjitha rastet e përmendura më sipër, ku punonjësja ***** është komanduar të kryejë këtë detyrë, Komisioneri konstaton se, si motiv janë paraqitur nevojat urgjente të punës, për shkak të veçorisë dhe kompleksitetit të natyrës së funksionit të Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë.

Duke analizuar aktet e njëpasnjëshme të komandimit/transferimit të nëpunëses, konstatohet se nga momenti i transferimit për herë të parë të punonjësës në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, e në vazhdim, kanë kaluar më shumë se 20 muaj dhe kjo punonjëse, ndërkohë rezulton të jetë paguar fillimisht me pagën e nivelit të specialistit, e më pas, me pagën e pozicionit të përgjegjësit të sektorit.

Me vendimin nr. 14 datë 29.01.2016, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 646/1 Prot., datë 08.10.2015*”, në lidhje me këtë problem, Komisioneri ka arsyetuar se : “*Komisioneri, në lidhje me këtë pretendim, vlerëson se problemi i pagës duhet të ishte shprehur në momentin e daljes së aktit të transferimit, duke përcaktuar njëkohësisht edhe efektin financiar në lidhje me këtë detyrë. Fakti që, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është çmuar që të mos ketë efekt financiar në lidhje me ndryshimin e pozicionit të punës për këtë nëpunëse, nuk përbën shkelje të dispozitave dhe përcaktimeve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.*”

Ndërkohë, me shkresën nr. 655, datë 19.02.2016, pas daljes së vendimit të përmendur më sipër, punonjësja *****, i ka kërkuar mendim Komisionerit, edhe në lidhje me pagën

që ajo duhet të marrë, për gjithë kohën e komandimit në detyrë për nevoja të institucionit, në pozicionin e punës, Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë.

Për sa i përket zgjidhjes së problemit që lind në këtë rast, vlerësohet se, në kushtet kur transferimi, apo komandimi në detyrën e drejtores në rastin konkret, nuk është bërë në përputhje me procedurën dhe kërkesat e nenit 48, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për arsyet e pëmendura hollësisht në vendimin e mëparshëm të Komisionerit, nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pika 5, e dispozitës së mësipërme, e cila parashikon shprehimisht: *“Gjatë periudhës së transferimit, nëpunësi civil përfiton pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar. Në çdo rast, nëse është e zbatueshme, nëpunësi civil përfiton shtesën për kushtet e punës të pozicionit në të cilin është transferuar”*.

Por, nga ana tjetër, duke u nisur nga ky parim i pranuar, do të ishte e drejtë që nëpunësja e komanduar të marrë pagën më të favorshme në raport me pagën që merrte në pozicionin *“Specialiste në Sektorin e Kurrikulës dhe Cilësisë”*, në fillim dhe të *“Përgjegjëses së Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë”*, ku ka kaluar pas konkurrimit, në përputhje edhe me përgjegjësitë e shtuara dhe vështirësitë e kryerjes së detyrës, në krahasim me pagën që merr aktualisht, si përgjegjëse sektori.

Ky arsyetim mbështetet jo vetëm në rregullin e parashikuar në dispozitën e cituar më sipër, por vjen në koherencë të plotë edhe me parimin e sanksionuar në Kushtetutë dhe në Kodin e Punës, për shpërbimin sipas sasisë dhe cilësisë së punës së kryer.

Marrëdhënia juridike e krijuar në rastin e komandimit, nga ana e drejtuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të nëpunëses civile *****, për kryerjen përkohësisht të detyrës së Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, ka dalë nga kufijtë e menaxhimit të drejtë të shërbimit civil, por kjo nuk duhet të shërbejë për penalizimin e saj, në drejtim të pagesës sipas punës që ka kryer në fakt, për gjithë periudhën e komandimit.

Për gabimet e lejuara në zbatimin e ligjit, nga ana e eprorëve, në kushtet e varësisë administrative të drejtpërdrejtë, nëpunësi i transferuar (*në rastin tonë, i komanduar*) nuk duhet të vihet në vështirësi e të diskriminohet, duke bërë një punë të nivelit drejtues, e duke u paguar me pagën e nivelit ekzekutiv.

Duke analizuar rrethanat e rastit në fjalë, Komisioneri vlerëson se duhet të plotësohet vendimi nr. 14, datë 29.01.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.646/1 Prot., datë 08.10.2015”*, duke u shprehur edhe për sa i përket aspektit të respektimit të të drejtave të nëpunësit civil, në lidhje me mënyrën e pagesës për punën e kryer.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15, 34, dhe 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 16, pikat 5, 8 dhe 9, si dhe nenin 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit,

VENDOSA

1. Plotësimin e Vendimit nr. 14, datë 29.01.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.646/1 Prot., datë 08.10.2015”*, të Komisionerit, si me poshtë:

Pas pikës 1, të shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

*“Ti kërkoj Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, me cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin administrativ të komandimit në detyrë, që të rivlerësojë situatën në lidhje me këtë veprim administrativ dhe të bëj plotësimin e aktit, duke urdhëruar pagimin e nëpunëses *****, për të gjithë periudhën e komandimit/transferimit të përkohshëm, me pagën e funksionit që ka kryer dhe kryen efektivisht, si Drejtore e Drejtorisë Arsimore, Rajonale, Tiranë, duke llogaritur dhe diferencën e pagës për periudhën e kaluar.”*

2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë dhe nëpunësja, *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA